

**AKT - THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISE TREGTARE**  
**“ALBANIAN ADVENTURE RESORT” SHA**

**Neni 1**  
**Formimi**

Formohet Shoqëria Aksionare me emrin Albanian Adventure Resort SHA me themelues :

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit**, e autorizuar me VKM 683, datë 15.10.2014, me numër NIPTI J 62119007 M, me seli në Tiranë, në adresën : “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë, këtu e përfaqësuar nga Ministre Znj. Lindita Nikolla, e bija e Lleshit lindur në Tiranë, më 22.10.1965 dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e dokumentit të identifikimit / kartës së identitetit me nr. 024428108.

- **Federata Shqiptare Rafting**, e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.3094, datë 26.05.2011, me numër NIPTI L12005452B, me seli në Bigaz, Skrapar, përfaqësuar nga Presidenti, Z. Zamo Spathara, i biri i Aliut, lindur në Berat, më 22/12/1967, banues në Berat në Lagjen “10 Korriku”, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit / kartës së identitetit me nr. 024844062.

**Neni 2**  
**Selia**

Shoqëria Aksionare Albanian Adventure Resort SHA e ka selinë në: Bigaz, Skrapar.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria Aksionare Albanian Adventure Resort SHA ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike të pakufizuar.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë Aksionare Albanian Adventure Resort SHA është:

A- Zhvillim i qëndrueshëm i produkteve dhe shërbimeve sportive-turistike në Shqipëri. Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve sportive-turistike do të bëhet në bazë të standardeve ndërkombëtare mbi parimin e përgjegjësisë sociale, duke kontribuar në ruajtjen e kulturës lokale dhe autenticitetin shqiptar dhe në mbrojtje të resurseve natyrore të vendit.

B- Ndërtimi dhe menaxhimi i resorteve sportive bazuar në parimet e ekologjisë.

Këto resorte midis të tjerave do shërbejnë si:

- qendër pritëse për sportistët shqiptarë dhe të huaj;
- Njësi grumbullimi materialesh sportive dhe njësi magazinimi;
- Njësi shërbimesh sportive;



- Njësi akomodimi për aktivitete sportive;
- qendër e formimit profesional në fushën e sportive dhe në fushat e tjera të lidhura me të;
- salla trajnimi për sportin;
- zyra kërkimi dhe publikimi në fushën sportive-turistike;
- qendër akademike për edukimin dhe rritjen e frymës sportive në grup për shkolla publike dhe private , institucione, kompani;
- qendër për organizimin e kampionateve kombëtare, ndërkombëtare dhe e eventeve të ndryshme.

C- Edukim dhe formim profesional në fushën sportive-turistike;

- Aktivitete në fushën e formimit profesional, nëpërmjet organizimit dhe menaxhimit të drejtëpërdrejtë të kurseve dhe trajnimeve profesionale dhe iniciativave të tjera të ngjashme.
- Aktivitete kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni në fushën e formimit, nëpërmjet ideimit, projektimit dhe koordinimit operativ dhe financiar në projekte të ndryshme;
- Aktivitete të projektimit dhe menaxhimit të programeve të bashkëpunimit, shërbimeve inovative në fushën kombëtar dhe ndërkombëtare;
- Aktivitete bashkëpunimi me organizata dhe entitete ndërkombëtare, publike dhe private, me qëllim përmbushjen e objektivit të shoqërisë si konferenca, seminare, tryeza të rumbullakëta, publikime dhe nëpërmjet formave të tjera të bashkëpunimit. Aktivitete të promovimit të formimit profesional në fushën sportivo-turistike, duke dhënë asistencë dhe konsulencë teknike, me qëllim përmirësimin e zhvillimit të aktiviteteve të kompanive dhe organizatave operuese në sektorin sportivo-turistik sipas shërbimeve përkatëse;
- Aktivitete të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave dhe dokumentacionit që ka lidhje me formimin profesional, duke punuar dhe shpërndarë sipas rastit, programe, publikime periodike apo me karakter teknik apo informues, duke promovuar dhe organizuar asamble dhe seminare, takime për studimin e temave dhe problematikave lidhur me edukimin dhe formimin profesional, publik dhe privat në fushën sportivo-turistike dhe në fushat e tjera të lidhura me të;
- Aktivitete të mbajtjes dhe zhvillimit të raporteve me administratën publike dhe gjithë institucionet e tjera publike dhe private, edhe ndërkombëtare që janë të interesuara dhe merren me formimin profesional në fushën sportivo-turistike dhe me temat e lidhura me të, si edhe me qëllimin për t'i prezantuar organeve kompetente të formimit profesional nevojat dhe kërkesat e ardhura nga sektoret e ndryshme në mënyrë që të orientohen aktivitetet për përfitime maksimale;
- Aktivitete të zhvillimit të strategjive të destinacioneve sportivo-turistike dhe planifikimit;

Ç - Promovimi i tregut sportiv;

- Promovimi i aktiviteteve sportive;
- Promovimi i ngjarjeve, vendeve, parqeve dhe aktiviteteve sportivo-turistike;
- Promovimi sportivo-turistik edhe në emër të autoriteteve lokale dhe qendrore të Republikës së Shqipërisë;

D – Krijim, organizim dhe rregullim i të gjitha agjencive, zyrave dhe filialeve të lidhura me objektin e shoqërisë.



*[Handwritten signatures]*

Për arritjen e këtyre qëllimeve shoqëria do të sigurojë tërë ndihmën teknike të nevojshme dhe do të lidhë kontrata për ndihmë teknike me ndërmarrje, persona juridik apo fizikë publikë dhe privatë, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ajo ka të drejtë të pranojë dhe aplikojë autorizime dhe lejet e duhura që do t'i nevojiten për arritjen e një ose më shumë nga qëllimet e lartë përmendura.

Për qëllim të realizimit të objektit të shoqërisë ajo mund të krijojë konsorciume, si me subjekte shqiptare, ashtu edhe me të huaj, me objekt të ngjashëm ose të lidhur me të.

Këto aktivitete do të zhvillohen me financime publike dhe/ose private, me fonde kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me organizata dhe subjekte publike dhe private.

#### **Neni 5 Kapitali i shoqërisë**

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është Lekë 3 500 000 lekë, i ndarë në 3 500 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1 000 lekë secili.

(2) Kapitali fillestar i shoqërisë përbëhet nga  $\frac{1}{4}$  e vlerës së mësipërme të shlyer nga Federata Shqiptare Rafting.

(3) Aksionarët e shoqërisë shlyejnë kuotat e tjera të kapitalit në shoqëri pas regjistrimit të shoqërisë në QKR, me mjete monetare apo në natyrë, sipas përcaktimeve të këtij statuti.

(4) Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit zotëron 910 aksione të zakonshme, të numëruara nga 1 tek 910, të barabarta me 26% të kapitalit të shoqërisë.
- Federata Shqiptare Rafting zotëron 2590 aksione të zakonshme të numëruara nga 911 tek 3500, të barabarta me 74% të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 6 Administratori**

Shoqëria Aksionare Albanian Adventure Resort SHA ka si Administrator të saj znj. Blerina Ago, shtetase shqiptare, lindur më 1.11.1987, në Berat, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me nr. 030003120.

#### **Neni 7 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës**

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Aksionare Albanian Adventure Resort SHA zgjidhen nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 8 Vula e shoqërisë**

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtje:  
"Shoqëria Aksionare Albanian Adventure Resort SHA".

#### **Neni 9 Bilanci dhe të ardhurat**



Viti financiar i Shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Raporti i administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së Përgjithshme brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

#### **Neni 10 Aksionari i vetëm**

Nëse shoqëria mbetet me një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Aksionari i Vetëm mund t'i delegojë kompetencat e tij.

#### **Neni 11 Prishja dhe likuidimi**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin "Për falimentimin" dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

#### **Neni 12 Dispozita të fundit**

Ky Akt themelues përpilohet në disa kopje, të cilat shpërndahen për :

- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për të bërë veprimet në Regjistrin Tregtar.
  - Dy kopje mbahen nga shoqëria si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Aksionare Albanian Adventure Resort SHA, ku secili nga aksionarët ka kopjen e tij.
- Akti firmoset rregullisht nga Aksionarët themelues të Shoqërisë Aksionare Albanian Adventure Resort SHA.


#### **Ortakët themelues të shoqërisë aksionare**

#### **"ALBANIAN ADVENTURE RESORT" SHA**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT      FEDERATA SHQIPTARE E RAFTING**

**MINISTËR**

**LINDITA NIKOËLA**

  
M. 9650/pro7  
01. 24. 12. 2014



**PRESIDENT**

**ZAMO SPATHARA**



**Statut i Shoqërisë Aksionare**  
**“ALBANIAN ADVENTURE RESORT” SHA**

**HYRJE**

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e faqes së internetit**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më <sup>24</sup> ..... / ..... / 2014, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri aksionare me emrin Albanian Adventure Resort ShA.

(2) Themeluesit e shoqërisë, bazuar në VKM 683, datë 15.10.2014 «Për dhënien e pëlqimit për krijimin e shoqërisë aksionare, ndërmjet Federatës Shqiptare të Rafting dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit», janë:

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit**, e autorizuar me VKM 683, datë 15.10.2014, me numër NIPTI J 62119007 M, me seli në Tiranë, në adresën : “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë, këtu e përfaqësuar nga Ministre Znj. Lindita Nikolla, e bija e Lleshit lindur në Tiranë, më 22.10.1965 dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e dokumentit të identifikimit / kartës së identitetit me nr. 024428108.

- **Federata Shqiptare Rafting**, e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.3094, datë 26.05.2011, me numër NIPTI L 12005452 B, me seli në Bigaz, Skrapar, përfaqësuar nga Presidenti, z. Zamo Spathara, i biri i Aliut, lindur në Berat, më 22/12/1967, banues në Berat në Lagjen “10 Korriku”, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit / kartës së identitetit me nr. 024844062.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

A- Zhvillim i qëndrueshëm i produkteve dhe shërbimeve sportive-turistike në Shqipëri.

Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve sportive-turistike do të bëhet në bazë të standardeve ndërkombëtare mbi parimin e përgjegjësisë sociale, duke kontribuar në ruajtjen e kulturës lokale dhe autenticitetin shqiptar dhe në mbrojtje të resurseve natyrore të vendit.

B- Ndërtimi dhe menaxhimi i resorteve sportive bazuar në parimet e ekologjisë.

Këto resorte midis të tjerave do shërbejnë si:

- qendër pritëse për sportistët shqiptarë dhe të huaj;
- Njësi grumbullimi materialesh sportive dhe njësi magazinimi;
- Njësi shërbimesh sportive;
- Njësi akomodimi për aktivitete sportive;



- qendër e formimit profesional në fushën e sportive dhe në fushat e tjera të lidhura me të;
  - salla trajnimi për sportin;
  - zyra kërkimi dhe publikimi në fushën sportive-turistike;
  - qendër akademike për edukimin dhe rritjen e frymës sportive në grup për shkolla publike dhe private , institucione, kompani;
  - qendër për organizimin e kampionateve kombëtare, ndërkombëtare dhe e eventeve të ndryshme.
- C- Edukim dhe formim profesional në fushën sportive-turistike;
- Aktivitete në fushën e formimit profesional, nëpërmjet organizimit dhe menaxhimit të drejtëpërdrejtë të kurseve dhe trajnimeve profesionale dhe iniciativave të tjera të ngjashme.
  - Aktivitete kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni në fushën e formimit, nëpërmjet ideimit, projektimit dhe koordinimit operativ dhe financiar në projekte të ndryshme;
  - Aktivitete të projektimit dhe menaxhimit të programeve të bashkëpunimit, shërbimeve inovative në fushën kombëtar dhe ndërkombëtare;
  - Aktivitete bashkëpunimi me organizata dhe entitete ndërkombëtare, publike dhe private, me qëllim përmbushjen e objektivit të shoqërisë si konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta, publikime dhe nëpërmjet formave të tjera të bashkëpunimit. Aktivitete të promovimit të formimit profesional në fushën sportivo-turistike, duke dhënë asistencë dhe konsulencë teknike, me qëllim përmirësimin e zhvillimit të aktiviteteve të kompanive dhe organizatave operuese në sektorin sportivo-turistik sipas shërbimeve përkatëse;
  - Aktivitete të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave dhe dokumentacionit që ka lidhje me formimin profesional, duke punuar dhe shpërndarë sipas rastit, programe, publikime periodike apo me karakter teknik apo informues, duke promovuar dhe organizuar asamble dhe seminare, takime për studimin e temave dhe problematikave lidhur me edukimin dhe formimin profesional, publik dhe privat në fushën sportivo-turistike dhe ne fushat e tjera të lidhura me të;
  - Aktivitete të mbajtjes dhe zhvillimit të raporteve me administratën publike dhe gjithë institucionet e tjera publike dhe private, edhe ndërkombëtare që janë të interesuara dhe merren me formimin profesional në fushën sportivo-turistike dhe me temat e lidhura me të, si edhe me qëllimin për t'i prezantuar organeve kompetente të formimit profesional nevojat dhe kërkesat e ardhura nga sektoret e ndryshme në mënyrë që të orientohen aktivitetet për përfitime maksimale;
  - Aktivitete të zhvillimit të strategjive të destinacioneve sportivo-turistike dhe planifikimit;
- Ç - Promovimi i tregut sportiv;
- Promovimi i aktiviteteve sportive;
  - Promovimi i ngjarjeve, vendeve, parqeve dhe aktiviteteve sportivo-turistike;
  - Promovimi sportivo-turistik edhe në emër të autoriteteve lokale dhe qendrore të Republikës së Shqipërisë;
- D – Krijim, organizim dhe rregullim i të gjitha agjencive, zyrave dhe filialeve të lidhura me objektin e shoqërisë.

Për arritjen e këtyre qëllimeve shoqëria do të sigurojë tërë ndihmën teknike të nevojshme dhe do të lidhë kontrata për ndihmë teknike me ndërmarrje, persona juridik apo fizikë publikë dhe privatë, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ajo ka të drejtë të pranojë dhe aplikojë autorizime dhe lejet e duhura që do t'i nevojiten për arritjen e një ose më shumë nga qëllimet e lartë përmendura.



Për qëllim të realizimit të objektit të shoqërisë ajo mund të krijojë konsorciume, si me subjekte shqiptare, ashtu edhe me të huaj, me objekt të ngjashëm ose të lidhur me të.

Këto aktivitete do të zhvillohen me financime publike dhe/ose private, me fonde kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me organizata dhe subjekte publike dhe private.

### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

### **Neni 4 Selia**

(1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bigaz, Skrapar

### **Kreu II Kapitali**

#### **Neni 5 Kapitali themeltar**

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është Lekë 3 500 000 lekë, i ndarë në 3 500 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1 000 lekë secili.

(2) Kapitali fillestar i shoqërisë përbëhet nga  $\frac{1}{4}$  e vlerës së mësipërme të shlyer nga Federata Shqiptare Rafting.

(3) Aksionarët e shoqërisë shlyejnë kuotat e tjera të kapitalit në shoqëri pas regjistrimit të shoqërisë në QKR, me mjete monetare apo në natyrë, sipas përcaktimeve të këtij statuti.

(4) Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit zotëron 910 aksione të zakonshme, të numëruara nga 1 tek 910, të barabarta me 26% të kapitalit të shoqërisë.
- Federata Shqiptare Rafting zotëron 2590 aksione të zakonshme të numëruara nga 911 tek 3500, të barabarta me 74% të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 6 Kërkesa për të paguar aksionet**

(1) Administratori mund t'u kërkojë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

#### **Neni 7 Llojet dhe kategoritë e aksioneve**



Aksionet e shoqërisë janë të zakonshme me të drejtë vote. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfutuar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë.

### **Neni 8 Regjistri i aksioneve**

Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

### **Neni 9 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të Aksioneve**

Aksionet e shoqërisë aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes së autorizuar për aksionarin shtet;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Aksionet dhe të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit 9901.

### **Neni 10 Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKR.

(2) Asambleja e përgjithshme vendos që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

(3) Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

### **Neni 11 Zvogëlimi i kapitalit themeltar**





Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

### **Kreu III Organet e shoqërisë**

#### **Neni 12 Organet e shoqërisë**

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Këshilli mbikëqyrës;
3. Administratori.

#### **Neni 13 Asambleja e Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
- d) emërimin dhe revokimin e administratorit të shoqërisë;
- e) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c", "d" dhe "e" të kësaj pike;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- i) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- j) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- k) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- l) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- o) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 14**

#### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët dhe nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit 9901.

Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i parashikon Neni 136 i Ligjit. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

#### **Neni 15**

#### **Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.

Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse Administratori nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

Administratori ose anëtari i Këshillit Mbikqyrës pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes, si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

#### **Neni 16**

#### **Kuorumi**

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit 9901, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me



të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.  
Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 17** **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të aksionarëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.  
Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti.

### **Neni 18** **Këshilli Mbikëqyrës**

- (1) Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.
- (2) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të Ligjit, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të rizgjidhen.
- (3) Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
  - a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
  - b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
  - c) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
  - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
  - e) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
  - f) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
  - g) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët;
  - h) të përcaktojë shpërblimin e administratorit;
- (4). Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, Këshilli Mbikëqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblesën e Përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

### **Neni 19** **Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**



(1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës do të mbahen të paktën dy herë në vit dhe sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e këtyre mbledhjeve.

(2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtar në momentin e emërimit.

(3) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit Mbikëqyrës, në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(4) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, pavarësisht nëse bëhet e ditur në vijim se emërimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllor sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(5) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës është njëllor i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikëqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

## **Neni 20**

### **Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës**

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve:


1. të gjithë takimeve të Këshillit Mbikëqyrës; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrat e Administratorit të pranishëm në çdo mbledhje.

## **Neni 21**

### **Largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

(1) Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

- a) personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
- b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose



e) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

## **Neni 22** **Administratori**

- (1) Asambleja e Përgjithshme emëron një administrator të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratori i shoqërisë mund të rizgjidhet. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.
- (3) Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqet Këshillit Mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
  - d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënon ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
  - e) të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
  - ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
  - f) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - g) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
  - gj) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
  - i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- (4) Detyrat, që i cakton ligji Këshillit Mbikëqyrës, nuk mund t'i delegohen administratorit.
- (5) Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratori duhet të informojë menjëherë kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës.

## **Neni 23** **Shkarkimi i Administratorit**

- (1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
  - a) personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;



- b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë; ose
- e) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e Administratorit të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

## **Kreu IV**

### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 24 Dividendët**

- (1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### **Neni 25 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorunit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

## **Kreu V Prishja dhe njoftimet**

#### **Neni 26 Prishja dhe likuidimi**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin "Për falimentimin" dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të



kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

**Neni 27**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 28**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



**Emrat dhe nënshkrimet e Aksionarëve Themelues të shoqërisë:**

**“ALBANIAN ADVENTURE RESORT” SHA**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT    FEDERATA SHQIPTARE RAFTING**



**MINISTRE**

**LINDITA NIKOLLA**

**PRESIDENT**

**ZAMO SPATHARA**

*n. 9650/1 mat*  
*QK 24.12.2014*